



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 410, datë 15.6.2022

P Ë R

**NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1144, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT
PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË OBJEKTIT "ATRIUM CENTER
THUMANA", NJËSIA ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA
KRUJË, DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË KRUJË SI NJËSI ZBATUESE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr.1144, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga Bashkia Krujë, për rindërtimin e objektit "Atrium Center Thumana", njësia administrative Thumane, Bashkia Krujë, në masën 176 168 718 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë dhe i transferohet Bashkisë Krujë, në formën e transfertës së pakushtëzuar."

2. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 3306/1
DATË 16.6. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFORMAVE ✓
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKISË KRUJË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

